



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QEDROR I ZGJEDHJEVE

Mbledhja e 24-të në vitin 2022

14 shtator 2022, ora 16:00

Hotel International, Shqipëri

Përmbledhje nga mbledhja e 24-të e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila u mbajt më 14 shtator 2022.

Kjo mbledhje u mbajt në Tiranë, në përfundim të ditës së dytë të punëtorisë për hartimin e planit strategjik të KQZ-së 20223 – 2026. Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ-së Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ibrahim Selmonaj, Alim Rama, Ilir Gashi, Rifat Krasnic, Cemajl Kurtisi, Udhëheqësja e Divizionit për Personel dhe Shërbime të përbashkëta, Vahide Behrami, përkthyesja, Jehona Cami dhe zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.

1. Hyrje

z. Kreshnik Radoniqi – Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kryesuesi i KQZ-së njoftoi anëtarët për rendin e ditës të propozuar dhe i njëjti u miratua nga të gjithë. Ky rend dite përmban zëvendësimin e dy anëtarëve të Kuvendeve Komunale në Prishtinë dhe Fushë Kosovë dhe vlerësimin vjetor të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çëshje Ligjore: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë dhe Fushë Kosovë.

Kryesuesi i Këshillit për Çëshje Ligjore, Sami Hamiti, prezantoi ndaras dy kërkesat e pranuar nga Kryesuesit e Kuvendeve Komunale të këtyre dy komunave për zëvendësimin e anëtarëve të tyre dhe theskoi se janë plotësuar kriteret ligjore për këtë gjë. Pas prezantimit, KQZ-ja mori vendim për:

- emërimin e z. Hafiz Krasniqi anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i cili do ta zëvendësojë z. Fisnik Osmani.
- emërimin e znj. Arbnore Kelmendi anëtare të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, e cila do ta zëvendësojë z. Driton Ademi.

3. Vlerësimi vjetor i punës së Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së

Në fillim të kësaj pike të rendit të ditës, Udhëheqësja e Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta, Vahide Behrami njoftoi anëtarët e KQZ-së se mënyra/procedura e vlerësimit vjetor të punës së KE të SKQZ-së nuk ka pësuar ndonjë ndryshim, pra është e ngjashme me atë të vitit të kaluar. Ajo gjithashtu, njoftoi KQZ-në, se anëtarja Gordana Laban e ka dërguar vlerësimin e saj përmes e-mail adresës. Kjo mënyrë është mundësuar edhe në vitet e kaluara.

Pas këtyre sqarimeve/njoftimeve, secilit prej anëtarëve të KQZ-së iu shpërnda nga një formular, të cilin e plotësuan dhe e dorëzuan.

4. Të ndryshme

Në pikën e katërt nuk u shtrua ndonjë çështje dhe kryesuesi i mbledhjes konstatoi përfundimin e saj.